

Komisioni për Ankesa – shkalla e dytë, në përbërje Sitki Baftiu kryetar, Remzi Azemi dhe Bekim Behrami anëtarë, në mbledhjen e mbajtur me datë: 10.05.2022 shqyrtoi ankesën e Valon Zymberi me nr ref.1055/1 datë: 05.05.2022, lidhur me vendimin e komisionit disiplinor të shkallës së parë të datës: 28.04.2022 dhe për të njëjtin duke iu referuar fakteve dhe provave nga lënda në shqyrtim lidhur me rastin, bazuar në dispozitat e Rregullores disiplinore Neni 119 Pika: a, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Refuzohet si e pabazuar** ankesa Valon Zymberi e dates:05.05.2022 e parashtruar kundër Vendimit të Komisionit Disiplinor të datës 28.04.2022
- II. **Vërtetohet** vendimi i komisionit disiplinor-shkallës së parë i datës 28.04.2022 me të cilin Valon Zymberit i janë shqiptuar masa disiplinore-dënimi me të holla në shumë prej: 200.00 €, të cilën shumë obligohet t'a paguaj në afat prej 8 ditësh pasi që vendimi të bëhet i formës së prerë dhe dënimi me ndalim në kryerjen e funksioneve si Drejtor sportive te klubi i futbollit Drita, në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili është i ekzekutueshëm nga momenti i shqiptimit.

A r s y e t i m

Komisioni për Ankesa – shkalla e dytë në mbledhjen e mbajtur më datë 10.05.2022 pas shqyrtimit të të gjitha shkresave, argumenteve dhe provave shtesë të deponuara nga ana e palës së ankimuar përkatësisht nga Valon Zymberi, konstaton se pala në procedurë nuk ka prezentuar fakte bindëse dhe relevante që ky komision do t'i kishte trajtuar në secilin pretendim të tij. Komisioni për Ankesa gjatë shqyrtimit të ankesës së Valon Zymberit gjeti se i njëjti nuk ka prezantuar asnjë fakt, dëshmi apo provë në realizimin e pretendimeve të tij të dhëna në emisionet televizive, pranë komisionit disiplinor dhe komisionit për ankesa.

Komisioni i Ankesave duke trajtuar ankesën në hollësi dhe vendimin e Komisionit disiplinor të shkallës së parë konstaton me të drejtë të plotë se janë shkelur dispozitat juridike respektivisht neni 61 paragrafi 1, pika b) e Rregullores Disiplinore ku parashihet se: *"Anëtari i organeve të FFK-së, apo zyrtari i klubit i cili fyen, shpif ose përhapë të pavërteta për klubin tjetër, për lojtarin e vet apo kundërshtarët, për punëtorin e futbollit të cilit do klub apo anëtarë të udheheqesise se organizates se futbollit të te cilitdo organ, per gjyqtarin ose trajnerin, do te denohet funksionari, me ndalesë të kryerjes se funksionit prej 6 (gjashtë) muaj deri ne 1 (një) vite dhe dënim me të holla 200€ deri 2000 €".* Gjithashtu në nenin 63, paragrafi 1, pika d) te kesaj rregulloreje parashihet se: *"Te gjithë personat te cilet nuk e aplikojne kodin e sjelljes (te cilet shkelin dispozitat e Kodit do te denohen : Punetori futbollit prej 3 muajve deri ne 1 vite por ne raste edhe me te renda perjashtim nga organizata e futbollit".* Në nenin 8, të Kodeksit për mirësjelljen e anëtarëve të FFK-se parashihet se: *"Anetarët e organizatave të futbollit nuk guxojnë gjatë deklaratave për media, të ofendojnë apo të përulin institucionet e organizatave të futbollit, të anëtarëve individual të tyre, nuk guxojnë të përhapin të pavërteta dhe të dhëna të rrejshme apo të gabuara lidhur me punën e institucioneve të futbollit dhe individëve, anëtarë të organizatave të futbollit."* Komisioni i Ankesave konstaton se shkalla e parë me të drejtë ka nxjerr përfundimin se kryesi i kundërvajtjes ka shkelur dispozitat e lartcekura, e të cilat edhe

janë zbatuar për shqiptimin e masës disiplinore.

Komisioni për Ankesa vjen në përfundim se kryesi i kundërvajtjes Valon Zymberi me veprimet e tij ka bërë shkeljen e dispozitave të lartcekura dhe masat që komisioni disiplinor-shkalla e parë i ka vendosur me vendim janë përputhshmëri të plotë nga veprimeve të palës në procedurë.

Andaj duke u bazuar në të cekurat si më lart, në përputhje me nenin 119, pika a) të Rregullorës Disiplinore, Komisioni i Ankesave e refuzoi ankesën e kryesit të kundërvajtjes, dhe e vërtetoi vendimin e shkallës së parë.

Prishtinë:

Datë 10.05.2022

Sitki Baftiu, kryetar i komisionit të ankesave

